



BASHKIA SHKODËR



**KLUBI I
FUTBOLLIT
"VLLAZNIA" SH.A**



**ALBAPHOTO SHPK-
DISTRIBUTOR I
AUTORIZUAR I
"FUJIFILM**



**SHOQATA E
BASKETBOLLIT
"VLLAZNIA"**

Nr. 9552 Prot

Nr. 212 Prot

Nr. 23 Prot

Nr. 91 Prot

MARRËVESHJE KUADËR

"PËR SPONSORIZIM, BASHKËPUNIM DHE PARTNERITET NË FUSHËN E SPORTIT"

Sot me datë 07/07/2020 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve, sikur vijon :

Partner përfitues dhe bashkëpunëtor i ofrimit të shërbimeve:

- a- **BASHKIA SHKODËR** me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit Bashkia Shkodër, në vijim referuar edhe si "Bashkia";
- b- **KLUBI I FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A**, me seli në adresën Stadiumi "Loro Boriçi", Shkodër, regjistruar me NIPT L17029001S, përfaqësuar nga Administratori z. Suad Lici.

të cilët këtu dhe në vijim të kësaj marrëveshje do të njihen si Grupi Përfitues (GP)

dhe

Bashkëpunëtor, Partner, dhe Sponsor në ofrimin e shërbimeve

- a- Shoqeria "ALBAPHOTO" shpk - **DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR I "FUJIFILM"**, me seli në adresën Rruga "Kolë Idromeno", Nd.89, H.3, Ap.30, Shkodër, regjistruar me NIPT K86618008S, me administrator z.Alban Xhaferi.
- b- **SHOQATA E BASKETBOLLIT "VLLAZNIA"**, me seli në adresën Pallati i Sportit "Qazim Dervishi", regjistruar me NIPT L17322191P, përfaqësuar nga Presidenti i saj z.Alban Xhaferi,

të cilët këtu dhe në vijim të kësaj marrëveshje, do të njihen si Grupi Partner(GPR).

Nënshkruesit e kësaj marrëveshje për sponsorizim dhe bashkëpunim, bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Baza ligjore

Kjo marrëveshje ka për mbështetje bazën ligjore sikur vijon:

- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- ligji nr.7850,datë 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH-së", i ndryshuar;
- ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar ;
- ligji nr.79/2017 datë 27.04.2017 "Për Sportin";
- ligji nr.7892 datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar;
- ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ;
- ligji nr.9753, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ;
- ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH-së", i ndryshuar ;
- ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Per tatimin mbi të ardhurat";
- ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare", i ndryshuar.
- Statuti e shoqërisë aksionare Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a krijuar me VKB nr. 9 datë 26.08.2011;

Neni 2 Preambul

Palët gjetën vullnet të përbashkët dhe mirëkuptim të plotë për lidhjen e kësaj marrëveshje afatgjatë, me etapa dhe terma të paracaktuar, në marrëveshje me Bashkinë Shkodër dhe në transparencë e mirëkuptim të plotë me interesin publik, bazuar në kushtet, të cilat ekzistojnë prapakisht si vijon:

- Shoqëria aksionere Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a. është me kapital 100% i Bashkisë Shkodër dhe zhvillon aktivitetin në fushën e sportit të futbollit, i cili është një sport me histori, traditë dhe interes për publikun shkodran dhe më gjerë;
- Shoqëria Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a operon me humbje dhe ka vonuar pagesat për përmbushjen e disa detyrimeve financiare korente përkundrejt disa debitorëve dhe institucioneve shtetërore;
- Shoqëria Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a ka lojtarë cilësorë, por rezultate të ulëta sportive të cilat rrezikojnë sërish rezultate të dobëta, jasht pritshmërive të publikut shkodran;
- Shoqëria Klubi i Futbollit "Vllaznia" sh.a është mbështetur vazhdimisht nga Bashkia Shkodër dhe megjithatë nuk ka qenë në nivelin e pritshmërive. Ajo ka qenë nën presionin e falimentimit, detyrimit për t'u angazhuar në forcimin e menaxhimit, tejkalimin e situatave të vështira teknike dhe financiare dhe diversifikimin dhe rritjen e të ardhurave të saj;



- Bashkia Shkodër, si aksioner i vetëm e ka të vështirë mbulimin e humbjeve financiare të Shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a, si rezultat i vështirësive financiare të trashëguara;
- “GPR” ka eksperiencën e përshtatshme dhe reputacionin e mirë në territorin e Bashkisë Shkodër në fushën e menaxhimit dhe marketing-ut në përgjithësi, dhe të veprimtarive sportive në veçanti.
- “GPR” ka burime financiare të ligjshme, që i mundësojnë ndërmarrjen e nismave për bashkëpunim dhe për të kontribuar në komunitetin ku ka qendrën e biznesit dhe më gjërë;
- “GPR” ka demonstruar vullnetin e tij për të kontribuar në komunitetin ku ushtron veprimtarinë ekonomike dhe aktualisht është i angazhuar në mbështetjen e veprimtarisë sportive të basketbollit;
- “GPR” ka shprehur publikisht vullnetin dhe interesimin për të zgjeruar mbështetjen e tij për sportin e futbollit si një vlerë historike dhe kulturore e Shkodrës;

Neni 3 Objekti i marrëveshjes


Kjo marrëveshje ka për objekt të saj:

a) Bashkëpunimi për konsolidimin e rezultateve të ekipit të parë dhe ekipeve të moshave të Akademisë “Vllaznia”, rikthimin e qëndrueshëm të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a në pozicion dinjitoz në renditjen e kampionantit kombëtar të futbollit të Superligës shqiptare dhe mundësinë për pjesëmarrje në aktivitete dhe kompeticione ndërkombëtare.

b) Partneritetin, midis paleve për të dhënë mbështetje teknike dhe financiare Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a., në bashkëpunim dhe harmonizim me angazhimet dhe kontributet teknike dhe financiare të vetë Bashkisë Shkodër si aksioneri i vetëm, por edhe të strukturave drejtuese, të personelit, lojtarëve dhe çdo aktori tjetër institucional, publik, privat dhe që ka interes.

Neni 4 Afati i marrëveshjes

Afati i vlefshmërisë do të jetë jo më gjatë se 5(pesë) sezone futbollistike (kampionate që shtrihen në dy vite kalendarike), përfshirë edhe periudhën nga data e lidhjes së kësaj marrëveshje për mbylljen e kalendarit dhe kohës së mbetur për sezonin 2019-2020. Marrëveshja i shtrin efektet e saj që nga momenti i nënshkrimit.






Neni 5 Te drejtat dhe detyrimet

a- “GPR” merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Përgatitjen e një plani emergjence dhe të treguesve të performancës që mundësojnë motivimin e personelit teknik dhe të lojtarëve për përmirësimin e renditjes së ekipit të futbollit në Superligën e Futbollit të Shqipërisë;
2. Mbështetjen për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të Shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a. bazuar në indikatorë dhe tregues të matshëm. duke patur në konsideratë:

I-Stabilizimin e vështirësive teknike dhe financiare ;

II- Konsolidimin e ecurisë dhe vijimësi;

III- Menaxhim cilësor dhe i përgjegjshëm i shoqërisë;

3. Mbështetje teknike për strategjinë afatgjatë për zhvillimin e veprimtarisë sportive të futbollit dhe ristrukturimin e Shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., përfshirë edhe riorganizimin dhe efektivitetin e funksionimit të akademisë së futbollit dhe diversifikimin e veprimtarisë së shoqërisë në funksion të garantimit të cilësisë sportive, të pritshme nga publiku i Shkodrës dhe më gjerë, si dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të saj;
4. Rekomandime për kandidatura për strukturat e shoqërisë, për treguesit e performancës së personelit administrativ dhe teknik, në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme;
5. Dhënia e mbështetjes financiare në vartësi të kapaciteteve të “GP” në formën e sponsorizimit, pa përjashtuar edhe financimin në formën e huapërdorjes (hua pa interes) për pjesën tjetër që mund të kërkohe apo ofrohet, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Disbursimin e mbështetjes financiare qoftë në formën e sponsorizimit apo të huapërdorjes sipas legjislacionit në fuqi, vetëm për qëllime të paracaktuara dhe të pranuar prej të gjithë partnerëve në këtë marrëveshje, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në pagesat për pagat e lojtarëve, trajnerëve të ekipit të parë dhe të akademisë, personelit të rëndësishëm administrativ dhe shpenzimeve të tjera që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e stërvitjes së ekipit dhe të ndeshjeve të tij të planifikuara, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Organizimin e marketingut, fushatave publicitare duke përdorur rrjetet sociale online, mediat e shkruara, ato elektronike për përftim të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a.
8. Heqjen dorë nga pretendimi për njohjen e shumës faktike të financimit si detyrime nga ana e Bashkisë Shkodër apo Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a., në rast të zgjidhjes apo ndërprerjes së kësaj marrëveshje në menyre të njëanshme nga ana e “GPR”.

b- “GP” merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Krijimin e një grupi pune, i cili do të punojë për përgatitjen e planit të emergjencës dhe treguesve përkatës të performancës, planin afatmesëm dhe strategjinë për konsolidimin dhe rritjen e Shoqërisë “KF Vllaznia sha”;
2. Analizën, vlerësimin dhe rishikimin e buxhetit 2020 dhe të projekt-buxhetit të 5(pesë) viteve të ardhshme, duke miratuar paraprakisht një mbështetje buxhetore të arsyeshme dhe të pranueshme për shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a..
3. Vlerësimin e detyrimeve të prapambetura të shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a. dhe marrjen përsipër të tyre duke i pasqyruar në bilancin e shoqërisë si detyrime të Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a.
4. Bazuar ne nenin 7 të Statutit të shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., të bëhet sistemimi (netimi) i kapitalit me humbje të mbartura dhe të merren masa për plotësimin e kapitalit minimal të deklaruar 2(dy) milion lekë, në kohë dhe sipas ligjit nr.9901.
5. Garantimin e transparencës së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., nëpërmjet vënies në dispozicion të publikut të gjerë të pasqyrave financiare dhe lejimit të mbikqyrjes dhe kontrollit nga ana e tij të zbatimin të kushteve të kësaj marrëveshje.
6. Përdorimin e sponsorizimit të dhënë nga “GPR” për objektet dhe qëllimet e paracaktuara prej tij, të dakordësuara me “GP”, për periudhën e buxhetit vjetor, atij afatmesëm, si dhe pasqyrimin e tij në librat e llogarisë të Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a., në përputhje me ligjin nr.25/2018 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
7. Kthimin e menjëhershëm të shumave të perfituara nga “GPR” për një periudhe jo më të gjatë se 30-dite dhe pa asnjë penalitet, në rast të zgjidhjes apo ndërprerjes së kesaj marrëveshje në menyre të njëanshme dhe pa arsye ligjore nga ana e GP, e vërtetuar me vendim të Gjykatës, sipas nenit 9.

8. Bashkëpunimin me “GPR” për marketing Marketingu do të realizohet në çdo formë komunikimi dhe reklame, për hapje dhe përdorimin e rrjeteve sociale dhe formave të tjera të marketing-ut për rritjen e audiences së ekipeve zinxhir, akademisë dhe të lidhura me to;
9. Lejimi i përdorimit të “Logo-s” së “GPR” veçmas dhe sipas marrëveshjes së sponsorizimit në veshjet dhe kostumet sportive dhe në çdo formë tjetër që mund të kërkohen prej tij, gjithmonë pas vendosjes së logove të “GP”, sipas stadarteve të FIFA, UEFA dhe FSHF;
10. Njohja apo lejimi i të drejtave të “GPR” për rishikimin dhe rregullimin e shumave të financimit në varësi të ngjarjeve pozitive që gjenerojnë të ardhura shtesë si rritja e shitjeve të biletave, pjesëmarrja në kupat e Europës, fitimin e titujve, reklammat në stadium, të drejtat televizive, përdorimi i ambienteve sportive, shitje të uniformave etj.
11. Mundësimin e të drejtës të “GPR” për të bërë agjentin, sipas legjislacionit në fuqi, për gjetjen dhe afrimin e lojtarëve cilesorë, që vetë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., dhe drejtimi i shoqërisë ka propozuar, ose ka miratuar. Këto operacione do të jenë në favor të shoqërisë Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a.
12. Krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e investimeve për zgjerimin e ambienteve sportive dhe krijimin/zhvillimin e Akademisë së Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a.
13. Angazhohet për të mbështetur dhe për të qenë bashkëpunuese në mënyrë që “GPR” të përfitojë nga zbatimi i saktë i ligjit për sportin dhe sponsorizimet.

Neni 6 Përfitimet dhe financimi e Klubit të Futbollit “Vllaznia” sh.a.

Shërbimet e përfituara dhe shumat e financuara nga “GPR” do të jenë;

- Sezoni që pritet të mbyllet, sipas kalendarit 2019-2020 do ketë një financim për shumën 2,000,000 leke
- Për çdo sezon apo kampionat shuma edhe në formën e sponsorizimit lidhur me kontratë të veçantë dhe pjesë integrale e kësaj marrëveshje kuadër do jetë në masën 20% të shumës financimit të kryer nga Bashkia Shkoder, por jo më pak se 15,000,000(pesembedhjetë milion) lekë dhe nivel maksimal ku përfshihet çdo kontribut deri në masen 20,000,000 lekë;
-
- Shuma e mesiperme nga ana e GPR do të konsiderohet e plotësuar nepermjet transfertave bankare në llogarinë e përfituesit ose nepermjet formave direkte të dhena nga GPR, me miratim të GP, të përcaktuara si: asistencë, konsulencë për

menaxhim, këshillim, mbështetje ligjore, audituese, shërbim me mjek dhe shërbime sigurimi të shëndetit, të ardhura apo fitime, pasojë e aktivitetit të shoqërisë tregtare të autorizuar për marketingun të dokumentuar sipas formateve dhe standarteve ligjore, të cilat do të paraqiten nga GPR tek GP.

- Të ardhura dhe donacione të tjera shtesë, me miratim në parim nga “GPR”, e të tjera të ardhura;
- Në rast të mos përmbushjes të detyrimeve për sponsorisim nga ana e GPR sipas përcaktimeve më sipër, GP i lind e drejta e rishikimit ose e anulimit të marrëveshjes.

Neni 7

Garancitë dhe të tjera të lidhura me marrëveshjen

Bashkia Shkodër angazhohet që të plotësojë në vlerë (sasi) dhe afat (datat e caktuara) fondet dhe kërkesat bazë për pjesën takuese sipas projekt-buxhetit të vitit aktual 2020, planifikimit për vitin e ardhshëm 2021 si dhe për periudhën e kohëzgjatjes së kësaj marrëveshje.

“GP” do të mbajë në kontroll humbjet, problematikat dhe detyrimet e mbartura para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

“GP” do të ushtrojë gjithë vullnetin e duhur për zbatimin e kësaj marrëveshje, duke garantuar zbatimin në tërësi të marrëveshjes dhe duke mos lejuar bllokimin për çfarëdoq problematike, përveç rasteve “*sui generis*” apo të shkatuara për dhe nga ngjarjet e forcës madhore.

“GPR” pranon se është përfshirë në këtë marrëveshje dhe partneritet me vullnetin dhe kontributet e tij sipas legjislacionit në fuqi.

Shuma e financuar nga ana e “GP” do të përdoret nga Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., për organizimin e aktivitetit normal të saj, pagesa të tatimeve, lojtarëve, trajnerëve të Akademise, trajnerëve të ekipit të parë, stafit drejtues, administrates, organizimit të takimeve dhe stërvitjes së ekipit, sipas prioriteteve dhe në marrëveshje me “GP”.

Administratori, Financa, dhe administrata e Klubi i Futbollit “Vllaznia” sh.a., kanë detyrim, në zbatim të kësaj marrëveshje, në dhe për emër të aksionarit “Bashkia Shkodër”, të raportojnë pasqyrat financiare dhe administrimin, si dhe të lejojnë apo krijojnë kushte për mbikqyrje dhe kontroll për zbatimin e kësaj marrëveshje nga persona të autorizuar nga palët respektive, me objekt verifikimin e shpenzimit të fondeve, situatës financiare të shoqërisë, performancës dhe treguesve teknik, progresivisht dhe në përgjithësi.

Neni 8

Përcaktimi i ngjarjeve të forcës madhore

Për efekt të zbatimit të kësaj marrëveshje, forcë madhore do të quhen:

- a. Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të pritëshin që të ndodhnin, kushtet

jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret apo dhe rrëshqitjet e tokës.

- b. Një akt lufte (qoftë i shpallur apo i pashpallur), pushtim, konflikt i armatosur apo akt i armikut të huaj, bllokadë, embargo, trazira, kryengritje, veprime terroriste ose ushtarake, çrregullime civile ose sabotime të motivuara politikisht, që tejkalon një periudhë që zgjat më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet paleve, Partnerit Sponsorizues "GPR" dhe Grupit Përfitues "GP" do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët i drejtohen për zgjidhjen e tyre Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në rastin e ndryshimit të pronësisë të Klubit të Futbollit "Vllaznia" sh.a., kjo marrëveshje do të konfirmohet nga asambleja e re e pronarëve.

Neni 10

Te Ndryshme

1. Pjesë integrale e kësaj marrëveshje kuadër janë marrëveshjet për sponsorizimin dhe marketingun.
2. Kjo marrëveshje u hartua në katër kopje, nga dy për secilën palë, të cilet pasi bien dakord, e nënshkruajnë atë rregullisht.

Shkodër, më _____

GRUPI PËRFITUES

GRUPI PARTNER

BASHKIA SHKODER

"ALBAPHOTO" SHPK- DISTRIBUTOR I AUTORIZUAR

KRYETARE
VOLTANA ADEMI

"FUJIFILM"
ADMINISTRATOR
ALBAN XHAFERI

KLUBI I FUTBOLLIT "VLLAZNIA"
SH.A.

SHOQATA E BASKETBOLLIT
"VLLAZNIA"

ADMINISTRATOR
SUAD LICI

PRESIDENT
ALBAN XHAFERI

